



ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



STATUTI

I.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.

Me këtë Statut përcaktohet emërtimi, selia, territori i veprimtarisë, synimet programore, format e organizimit të brendshëm, autorizimet dhe detyrat e Kuvendit, Këshillit Drejtues, Kryesisë dhe anëtarësisë së gjerë ndaj realizimit të qëllimeve të saj.

2.

Emërtimi i plotë është: Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shkurtesa: **OVL të UÇK-së** (në tekstin e mëtutjeshëm Organizata).

Selia e Organizatës është në Prishtinë.

Simboli i Organizatës, është i njëjtë me emblemën e UÇK-së.

Kryesia e Organizatës posedon me vulën e vet, me emërtimin e Organizatës në të. Vula e protokollit caktohet me rregullore nga Kryesia.

Kryesia e Organizatës, ka letrën zyrtare, me shqiponjën dykrenare të flamurit majtas, simbolin e vet djathtas, e në mes shkruhet emri i plotë i Organizatës.

3.

Degët e OVL të UÇK-së janë në qendrat komunale.

Kryesia e Degës, posedon me vulën e Organizatës, me emërtimin e OVL të UÇK-së dhe emrin e komunës, ose territorin ku vepron.

Kryesia e Degës, vepron në harmoni me administratën qendrore dhe simbolet e saj.

4.

OVL të UÇK-së është organizatë joqeveritare e jopartiake e bashkimit të lirë dhe të vullnetshëm të të gjithë luftëtarëve të UÇK-së.

5.

Organizata, në përputhje me Programin dhe Statutin synon:

- njohjen dhe avansimin e statusit të luftëtarëve të UÇK-së, dëshmorëve, familjeve të tyre dhe mbrojtjes së dinjitetit dhe integritetit të tyre;
- ruan nderin, karakterin dhe idealin çlirimtar të luftës së UÇK-së;
- të ndihmojë luftëtarët e UÇK-së dhe familjet e tyre në realizimin e të drejtave të tyre dhe të ruajë, mbrojë e avansojë vlerat e shenjta të luftës çlirimtare.

Detyrat dhe angazhimet e Organizatës janë:

- angazhimi për mbrojtjen juridike dhe sociale të anëtarëve të Organizatës dhe familjeve të tyre;
- angazhimi në ngritjen profesionale dhe punësimin e anëtarëve të Organizatës;
- mbrojtjen shëndetësore të anëtarëve të Organizatës dhe familjeve të tyre;
- sigurimin e pjesëmarrjes aktive të Organizatës dhe anëtarëve të saj, si dhe ndikimit të tyre në të gjitha sferat e jetës në Kosovë;
- ndihma ndaj organeve përkatëse të Kosovës, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe mbrojtjen e vendit nga çfarëdo rreziku që i kanoset;
- ndihma ndaj organeve përkatëse të Kosovës në luftimin e krimit dhe demaskimin e profiterëve të luftës dhe dezertërëve;

- marrja pjesë aktive në realizimin e vetvendosjes, ndërtimin, zhvillimin e forcimin e shtetit, ekonomikisht dhe ushtarakisht;
- kultivimi i atdhetarizmit dhe nacionalizmit shqiptar;
- përkujdesja për invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve dhe familjet e invalidëve;
- bashkëpunimi me SHIL të UÇK-së, SHFD të UÇK-së si dhe organizatat që merren me çështjet e civilëve të vrarë, invalidëve civilë, robërve të luftës dhe të pagjeturve gjatë luftës çlirimtare;
- mbrojtja e komplekseve memoriale, lapidarëve, varrezave të dëshmorëve, muzeve të luftës dhe të ngjajshme;
- aktivitetet botuese;
- rezervimi i të drejtës së kontrollit dhe ndalimit të botimeve për UÇK-në, fotografive të dëshmorëve etj;

si dhe detyra të tjera që parashihen me Statutin e Programin e Organizatës, si dhe me vendimet e organeve drejtuese.

6.

Format e veprimtarisë dhe të ndikimit të Organizatës janë të shumëllojshme dhe në pajtim me praktikën demokratike të veprimit: kërkesat zyrtare publike, peticionet, protestat, demonstratat, marshimet, lobimet në institucione dhe formave të tjera që krijojnë opinion ndikues në procese dhe në vendimmarrje të niveleve të ndryshme.

7.

Organizata vepron në tërë territorin shtetëror të Republikës së Kosovës. Organizata për nevojat e veta, hap zyret e veta edhe jashtë territorit të Kosovës.

8.

Aktivitetet e OVL të UÇK-së janë publike. Aktivitetet e Organizatës publikohen përmes mediave elektronike dhe të shkruara, botimeve të posaçme dhe formave tjera të veprimtarisë informative. Anëtarësia e Organizatës njoftohet direkt përmes organeve drejtuese. Vendimi për pjesëmarrje në mbledhje, të gazetarëve, apo personave tjerë që nuk i përkasin organit drejtues që mblidhet, merret në fillim të mbledhjes.

9.

Vendimet e organeve drejtuese të Organizatës janë të vlefshme nëse shumica e antarëve të tyre janë prezent, përveç nëse me Statut caktohet ndryshe. Vendimi është i plotfuqishëm, nëse votohet nga shumica e të pranishmëve, përveç nëse me Statut caktohet ndryshe. Zgjedhjet e organeve bëhen me vota të fshehta, ndërsa vendimet votohen haptazi.

10.

Organizata feston 28 Nëntorin si festë të shumëfishtë dhe gjithëkombëtare, 17 shkurtin si ditë të Pavarësisë së Kosovës, 5 Majin Ditën e Dëshmorëve të kombit shqiptar, Epopenë e UÇK-së 5 - 7 mars, 30 dhjetorin si Dita e Veteranit, manifestime në datat e krijimit të zonave operative si dhe ditët që përkojnë me kalendarin e UÇK-së.

II.ANTARËSIA

11.

Anëtar i Organizatës mund të bëhet secili pjesëmarrës i ndonjë njësie të UÇK-së, prej themelimit e deri më 20 qershor 1999. Verifikimi i antarëve është përgjegjësi e degëve të Organizatës. Me rregullore të posaçme, Këshilli drejtues kategorizon antarët e organizatës, në bazë të kontributit të tyre gjatë luftës çlirimtare.

12.

Anëtari i OVL të UÇK-së ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Organizatës, të shtrojë pyetje, ankesa propozime e sugjerime.

Të drejtën e udhëheqjes në Organizatë, e kanë luftëtarët e kyçur para 24 marsit 1999.

Anëtari i Organizatës ka të drejtë të pajiset me Kartelën e Veteranit, në bazë të procedurave të caktuara nga Kryesia Qendrore.

Poseduesi i Kartelës së Veteranit, gëzon statusin e veteranit dhe të gjitha të drejtat e caktuara me ligj.

13.

Anëtar nderi të Organizatës mund të shpallen personat që e kanë ndihmuar, përkrahur dhe që kanë kontribuar në Luftën Çlirimtare të UÇK-së, në bazë të kriterëve që caktohen nga Këshilli Drejtues.

Ata që nuk kanë qenë në luftë, por që e përkrahin Organizatën, moralisht e financiarisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizatë si përkrahës.

Përkrahësit e organizatës pajisen me dokument të posaçëm dhe mbahen në evidencë.

14.

Askush nuk mund të konsiderohet anëtar i Organizatës, nëse ka vepruar në kundërshtim me parimet dhe idealin e luftës për çlirim, apo në ndonjë mënyrë ka bashkëpunuar me armikun.

15.

Anëtari përjashtohet nga Organizata për këto arsye:

- a) Shkelja e Programit, Statutit, rregulloreve, vendimeve, apo akteve tjera të organizatës,
- b) Shkelja dhe njollosja e vlerave të luftës së UÇK-së,
- c) Bashkëpunimi me armikun,
- d) Nëse si epror i UÇK-së, ka dhënë dëshmi të rrejshme për luftën
- e) Vendosja e interesave partiake, apo interesave tjera mbi interesat e organizatës,

Vendimin për përjashtim të anëtarit e marrin komisionet disiplinore të degëve ose Kryesia Qendrore.

16.

Anëtari i Organizatës e ka obligim që të punojë në bazë të Programit, Statutit dhe akteve tjera të Organizatës.

Çdo anëtar i OVLUÇK-së, është i obliguar që ta luftojë me të gjitha mjetet e lejuara parcializmin dhe rajonalizimin e luftës së drejtë çlirimtare të UÇK-së për interesa partiake. Nëse veterani tregon pasivitet apo përkrahë ndasitë e këtilla përjashtohet menjëher nga Organizata.

Anëtari i Organizatës e ka obligim që:

- a) Të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes kombëtare,
- b) T'i mbrojë dhe avansojë vlerat e shenjta të UÇK-së dhe gjakun e derdhur të dëshmorëve,
- c) Të punojë, ndihmojë, njoftojë dhe realizojë me përgjegjësi detyrat e besuara nga Organizata.

III.ORGANIZIMI I BRENDSHËM

17.

Organizata vepron në principin territorial nëpër komuna.

Hasi dhe Hani i Elezit, organizohen si degë të posaçme, me kompetenca të njëjta si degët e tjera.

18.

Dega e Organizatës punon në bazë të këtij Statuti, gjithashtu miraton duke u mbështetur në këtë Statut: Rregulloren e Punës, Rregulloren e Sekretarisë dhe Rregulloren Financiare.

Dega që ka më tepër se 200 anëtarë, me vendim të posaçëm, formon nëndegët e veta në bashkësi lokale, bashkësi fshatrash, apo lagjesh, siç e kërkon nevoja e organizimit.

IV.ORGANET DREJTUESE

19.

Nëndega organizohet sipas rregullave që i përcakton Kryesia e Degës.

Degët e organizatës kanë Kuvendin, i cili përbëhet nga 17 deri më 145 delegatë të cilët zgjedhen nëpër nëndegë. Këshilli Drejtues i degës përbëhet nga 15 deri 27 anëtarë. Kryesia e degës ka 5 deri 9 anëtarë.

20.

OVL të UÇK-së udhëhiqet nga organet qendore që janë: Kuvendi, Këshilli Drejtues dhe Kryesia.

21.

Kuvendi është organi më i lartë i Organizatës.

Kuvendi mbledhet çdo katër vjet në seancë të rregulltë. Seanca e jashtëzakonshme thirret me kërkesën e 2/3 të antarëve të Këshillit Drejtues ose me kërkesën e 1/3 së degëve.

Puna e Kuvendit rregullohet me Rregulloren e Kuvendit që miratohet nga Këshilli Drejtues.

22.

Delegatët për Kuvend qendror zgjedhen nga kuvendet e degëve.

Secila degë, në mënyrë proporcionale delegon 3 delegatë. Për çdo 500 të anëtarësuar shtohet një delegat.

23.

Mandati i delegatëve të Kuvendit zgjat katër vjet.

Mandati i delegatit mund të revokohet edhe para këtij afati, po që se delegati kryen veprime të ndaluara me Statut, Kodin e Etikës dhe Rregulloren Disiplinore.

Revokimi i mandatit të delegatit bëhet nga organi që e ka zgjedhur.

24.

Kuvendi kryen këto detyra:

- angazhohet për realizimin e të gjitha të drejtave që iu takojnë anëtarëve të Organizatës;
- shqyrton situatën dhe pozitën e tërësishme lidhur me të drejtat dhe obligimet e anëtarësisë;
- aprovon Programin dhe Statutin e Organizatës;
- plotëson përbërjen e Këshillit drejtues;
- aprovon Raportin e Punës dhe Raportin Financiar;
- shpërndan tituj e çmime nderi për luftëtarët;
- përcakton politikën e punës së Organizatës;

Gjithashtu kryen edhe detyra tjera në pajtim me Statutin.

25.

Këshilli Drejtues është organi më i lartë i Organizatës mes dy kuvendeve.

Seancat e Këshillit Drejtues mbahen çdo tre muaj. Seancat e jashtëzakonshme thirren nga 2/3 e Kryesisë, ose nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Seancat e Këshillit Drejtues kryesohen nga kryetari.

26.

Këshilli Drejtues ka 51 antarë.

Në përbërje të Këshillit drejtues janë kryetarët e degëve, e pjesa tjetër zgjidhet nga Kuvendi.

Në rast të dorëheqjes, largimit, apo përjashtimit të ndonjë anëtari, Këshilli Drejtues ka të drejtën e kooptimit të një anëtari tjetër, sipas radhës, bazuar në votat e fituara në Kuvend.

27.

Këshilli Drejtues zgjedh Kryetarin e Organizatës. Zgjedhja domosdoshmërisht bëhet me vota të fshehta dhe kur në seancë marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Në rast se propozohen dy apo më tepër kandidatë për kryetar dhe asnjëri prej tyre në votimin e parë nuk fiton mbi gjysmën e votave të anëtarëve prezent, bëhet një votim i ri në mes të dy kandidatëve që kanë fituar vota më së shumti.

Këshilli Drejtues zgjedh edhe 14 anëtarë të Kryesisë.

28.

Këshilli Drejtues kryen edhe këto detyra:

- miraton Rregulloren e Punës së Kryesisë;
- përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Kuvendit;
- nxjerr dhe miraton Planin operacional organizativ të Organizatës;
- kujdeset për të drejtat dhe obligimet e çdo anëtari të Organizatës;
- kontrollon dhe koordinon punët në mes të degëve dhe Kryesisë Qendrore;
- mbikqyrë punën e Kryesisë dhe administratës së saj;
- shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e anëtarëve të OVL UÇK
- miraton Kodin e Etikës dhe akte tjera të nevojshme;
- jep sugjerime, këshilla dhe urdhëresa të nevojshme;
- përkujdeset për funksionimin e të gjitha organeve drejtuese të Organizatës;
- themelon sektoret punuese të përhershme, apo të përkohshme, si dhe nxjerr rregulloret për punën e tyre:

- Redaksia e botimeve;
 - Sektori i punësimit, mbrojtjes juridike dhe shëndetësore;
 - Sektori i Analizave dhe Informimit;
 - Komisioni Statutar;
 - Komisioni i Revisionimit;
 - Sektori për Marrëdhënie Ndërkombëtare;
 - Sektori i Historisë së Luftës, kalendarit historik dhe arkivimit;
 - Sektori i Gradimit dhe Dekorimit;
 - Sektori për Përkujdesjen ndaj Invalidëve të Luftës dhe Familjarëve të Dëshmorëve;
- dhe sektore tjera sipas nevojës.

Kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë Statut dhe akte të tjera ligjore.

29.

Kryesia është organ ekzekutiv i Këshillit Drejtues.

Kryesia përbëhet nga 15 anëtarë.

Kryesia nga radhët e veta zgjedh dy nënkryetarë dhe sekretarin.

Kryesia emëron zëdhënësin e Organizatës dhe këshilltarin politik-juridik.

Seancat e Kryesisë i kryeson kryetari.

30.

Kryesia e Organizatës:

- koordinon punën e Organizatës mes dy mbledhjeve të Këshillit Drejtues;
- përgatitë mbledhjet e Këshillit Drejtues;
- koordinon punët me degët e Organizatës;
- përgjegjet për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- miraton Rregulloren Financiare.

Gjithashtu kryen edhe detyra tjera në pajtim me Statut

31.

Kryetari i Organizatës:

- përfaqëson Organizatën;
- koordinon funksionimin e Organizatës;
- përgjegjet për zbatimin e vendimeve të Kryesisë;
- thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kryesisë dhe Këshillit drejtues.

Gjithashtu, kryen edhe detyra tjera që parashihen me Statut dhe vendime të organeve drejtuese.

32.

Kryetari mund të inicojë procedurën e shkarkimit të çdo anëtari të Kryesisë, para Këshillit drejtues, atëherë kur konsideron se ndonjëri nga antarët nuk i përmbahet vendimeve të Kuvendit, Këshillit Drejtues, apo të Kryesisë, ose me veprimet e veta njollos qëllimet e Organizatës.

Të njëjtën procedurë për Kryetarin mund ta nisin së paku 5 anëtarë të Kryesisë, apo së paku 17 anëtarë të Këshillit Drejtues.

V.FINANCIMI DHE PASURIA

33.

OVL të UÇK-së është organizatë jopfitabile dhe mjetet e saj shërbejnë ekskluzivisht për mbulimin e qëllimeve programore dhe aktiviteteve.

34.

Organizata financohet nga:

- Buxheti Qendror;
- Buxheti komunal;
- Pagesa e anëtarësisë një euro në muaj;
- Kontributet vullnetare dhe
- Donacionet.

Kryesia Qendrore dhe degët kanë xhirollogaritë e veta ku grumbullohen të hyrat në Organizatë. Menaxhimi i mjeteve përcaktohet me rregulloret financiare të degëve dhe Kryesisë Qendrore.

Degët dorëzojnë 40% të anëtarësisë në Kryesi.

VI.KOMISIONI STATUTAR

35.

Komisioni Statutar është organi ekzekutiv i kontrollit, mbikqyrjes, zbatimit dhe i ekzekutimit të drejtë e ligjor, të këtij Statuti dhe akteve tjera juridike, të inicuar nga vet ky komision apo me kërkesën e degëve, Këshillit Drejtues, Kryesisë apo Kryetarit.

Anëtarë të Komisionit Statutar nuk mund të zgjedhen anëtarët e Kryesisë.

Komisioni Statutar ka pesë anëtarë.

Komisionin Statutar e zgjedh Këshilli Drejtues. Anëtarët e komisionit statutar duhet të jenë juristë të diplomuar dhe veteran të UÇK-së.

36.

Komisioni Statutar inicon procedurën e ligjshmërisë së punës së çdo anëtari të Organizatës me vetiniciativë, apo me kërkesën e ndonjë organi drejtues të Organizatës.

Komisioni Statutar është i obliguar që për çështjet që i adresohen, të vendos në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës.

VII.PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE DHE E DREJTA NË ANKESË

37.

Për moskryerje të obligimeve dhe për njollosjen e autoritetit të Organizatës, antarët mbajnë përgjegjësi në bazë të rregullave që i cakton Programi dhe Statuti.

Komisioni disiplinor i degës dhe Kryesia Qendrore vendosin në shkallën e parë.

38.

Shkalla e dytë për ankesat ndaj vendimeve të komisioneve disiplinore të degëve është Komisioni Disiplinor Qendor. Shkalla e dytë për ankesat ndaj vendimeve të Kryesisë Qendrore është Këshilli Drejtues.

Anëtari ka të drejtën e ankesës në shkallën e dytë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi i shkallës së dytë është definitiv.

39.

Komisioni Disiplinor i degës dhe ai qendror ka Kryetarin dhe katër antarë.

Kryetari dhe antarët e Komisionit Disiplinor zgjedhen nga Këshilli Drejtues.

40.

Komisioni Disiplinor (i degës dhe ai qendor) mblidhet me kërkesën e Këshillit Drejtues, Kryesisë apo Kryetarit.

Komisioni Disiplinor (i degës dhe ai qendor) inicon në afat prej 15 ditësh çështjet që i paraqiten.

Antarët e Komisionit Disiplinor, nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë.

Mandati i antarëve të Komisionit Disiplinor zgjatë katër vjet.

41.

Shkalla e parë (Komisioni Disiplinor i Degës ose Kryesia Qendrore) merr këto vendime:

- vërejtje;
- suspendim;
- përjashtim për kohë të caktuar; dhe
- përjashtim.

42.

Shkalla e dytë (Komisioni Disiplinor Qendor ose Këshilli Drejtues) pas shqyrtimit të vendimit të shkallës së parë, merr këto vendime:

- Vërteton vendimin;
- Ndryshon vendimin;
- Hedh poshtë vendimin.

43.

Shkalla e parë dhe e dytë vendosin me shumicën e përbërjes së vet.

44.

Vendimi i shkallës së dytë i dedikohet me shkrim: Këshillit Drejtues, Kryesisë dhe palës.

VII.DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

45.

Anëtari i ndonjë organi të Organizatës, konsiderohet se i ka pushuar funksioni nëse pa kurrfarë arsytimi nuk merr pjesë 3 herë në mbledhje.

46.

Anëtarët e Kryesisë, si në nivelin lokal po ashtu edhe në atë qendror, nuk mund të kenë poste partiake apo shtetërore, si pjesëtar të PK-së, FSK-së apo Shërbimit informativ sekret të shtetit.

47.

Interpretimin e këtij Statuti e bëjnë në radhë hierarkike: Komisioni Statutar, Këshilli Drejtues dhe Kuvendi.

48.

Çdo akt normativ tjetër që e aprovojnë organet e Organizatës, detyrimisht duhet të jetë në pajtim me këtë Statut.

49.

OVL të UÇK-së përfundon së ekzistuari me një vendim që merret me referendum, në të gjitha degët e Organizatës. Për suksesin e referendumit vendosin 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast të përfundimit të ekzistimit, të mirat materiale dhe arkivi i dokumenteve të Organizatës i kalon Shtetit.

50.

Në rast lufte, apo në raste tjera të jashtëzakonshme, kur nuk ka mundësi të funksionimit të organeve drejtuese, të gjitha kompetencat i kalojnë Kryesisë së Organizatës. Vendimet e Kryesisë në këto raste, janë të plotfuqishme dhe të obligueshme për tërë antarësinë. Këto kompetenca Kryesia i mban deri në ndërprerjen e luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme. Menjëherë pas kësaj, Kryesia i përgjigjet Këshillit Drejtues për të gjitha vendimet dhe veprimet e veta.

51.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti ka të drejtë t'i bëjë vetëm Kuvendi i Organizatës, me propozim të Komisionit Statutar, Kryesisë apo Këshillit Drejtues. Plotësimet dhe ndryshimet e propozuara aprovohen me shumicë votash të delegatëve prezent në Kuvend.

52.

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi.

Miratuar me 24 janar 2009 nga Kuvendi i Tretë Zgjedhor i OVL të UÇK-së

Kryetari: Muharrem Xhemajli